



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2024
Nr. Dok. 202400531/2

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë.

Drejtuar: Z. Klevis QOSE
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Edmond LEKA
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

VLORË

Të nderuar zotërinj,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin tuaj dhe punën e stafit të institucionit që ju drejtoni në respektimin e të drejtave të të burgosurve, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, nga inspektimi periodik që u zhvillua në IEVP Vlorë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81, datë 25.06.2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim periodik në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Vlorë, më datë 29.04.2024, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, znj. Lindita Dedëgjonime me detyrë nd/komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar, si dhe znj. Edlira Cimbi me detyrë nd/komisionere pranë Seksionit të Veçantë.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, garantimi i të drejtave dhe trajtimi i të dënuarve dhe paraburgosurve në bazë të akteve ligjore e nënligjore dhe dokumenteve ndërkombëtare në fuqi, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Gjatë vizitës monitoruese, grupit të inspektimit ju ofrua mundësia që të kishin akses të plotë në këqyrjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar, inspektimin dhe evidentimin e kushteve ku mbahen dhe trajtohen të dënuarit dhe paraburgosurit në këtë institucion, ambientet e banimit, vendet e ajrimit, dhomat e observimit dhe të veçimit, në ambientin e infermierisë, klasat e edukimit, kuzhinë, lavanderi etj., si dhe bënë këqyrjen e dokumentacionit që administrohej nga punonjësit sipas sektorëve të institucionit.

Mekanizmi Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Inspektimi i MKPT-së në IEVP Vlorë, u krye pa paralajmërim dhe pa mbikëqyrjen e stafit të institucionit, me zhvillimin e intervistave konfidenciale me të burgosurit, si dhe u zhvillua në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Bazuar në metodologjinë e inspektimit, grupi i MKPT-së zhvilloi një takim me drejtorin e institucionit të IEVP-së Vlorë z. Edmond Leka dhe shefin e policisë z. Lefter Shehu, të cilët u vunë në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Grupi i inspektimit kërkoi gjithashtu vënien në dispozicion të kopjeve të praktikave të punës që ndiqen nga sektori juridik, sektori psiko-social, sektori i shërbimit shëndetësor, kopje të organikës së institucionit, si dhe të informacioneve të dërguara Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga sektori ekonomik dhe ai i burimeve njerëzore, në lidhje me planifikimin e fondeve për investime në godinat e banimit në regjimin e brendshëm etj.

Nisur nga infrastruktura e godinave në regjimin e brendshëm, elementët e sigurisë, cilësia e shërbimeve që ofrohen, si dhe ambientet e jashtme që shërbejnë për ajrim dhe aktivitete të përbashkëta, theksojmë se IEVP Vlorë garanton standarde të pranueshme për sa i përket kushteve infrastrukturore për të dënuarit dhe të paraburgosurit.

Me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 "*Për disa ndryshime në Urdhërin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale"*, IEVP Vlorë klasifikohet burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion siguri të zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

Në ditën e inspektimit në IEVP Vlorë ishin të akomoduar 157 të burgosur, nga të cilët 10 të dënuar dhe 147 të paraburgosur. Në akomodimin e këtyre të burgosurve ishin 5 persona të moshës 18-21 vjeç, për të cilët nuk kishte dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këtë kategori, si dhe 13 persona të sëmurë me probleme të shëndetit mendor, për të cilët nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë (SKV).

Kapaciteti zyrtar i institucionit ishte për 156 persona, pa përfshirë këtu ambientet e dhomave në sektorin e infermierisë, si dhe sektorin e observimit dhe veçimit, pasi kapaciteti arrin në një total prej 160 personash¹.

¹ Sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.735 datë 04.05.2023 "*Për miratimin e Kapacitetit të Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendime Penale*", parashikohet se: "*IEVP Vlorë ka për kapacitet 160 të burgosur*".

Gjithashtu, grupi i inspektimit kërkoi informacion për situatën e popullimit edhe për periudhën vjetore të inspektimit, e cila rezultoi si më poshtë vijon:

1. Muaji Nëntor	2023	157 të burgosur (143 të P/B dhe 14 të dënuar).
2. Muaji Dhjetor	2023	158 të burgosur (144 të P/B dhe 14 të dënuar).
3. Muaji Janar	2024	169 të burgosur (138 të P/B dhe 31 të dënuar).
4. Muaji Shkurt	2024	187 të burgosur (152 të P/B dhe 35 të dënuar).
5. Muaji Mars	2024	170 të burgosur (143 të P/B dhe 27 të dënuar).
6. Muaji Prill	2024	157 të burgosur (147 të P/B dhe 10 të dënuar).

Sikurse paraqitet nga grafiku i statistikave, rezulton se IEVP Vlorë ka patur popullim në kapacitetin fizik të institucionit, gjatë periudhës 6-mujore. Nga inspektimi u konstatua se episode të herëpashershme mbipopullimi përgjithësisht në disa sektorë të të paraburgosurve ishin mbi kapacitet, ku ata ishin të pajisur me shtretër për fjetje dhe të vendosur në dhoma të destinuara për 2, 3, 4 dhe 6 persona, duke ngushtuar në këtë mënyrë hapësirat e dhomave ekzistuese.

Rritja e numrit të shtretërve brenda dhomave nuk është tregues që përcakton kapacitetin fizik të institucionit, pasi janë çënuar kushtet për jetesë normale të këtyre shtetasve. Konkretisht, në shumicën e dhomave ku ishin akomoduar personat, hapësira dhe sipërfaqja e banimit nuk i përgjigjej parametrave teknike dhe jetësore që i takon çdo personi, sikurse është e miratuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, por edhe larg standardeve ndërkombëtare që synohen të arrihen për këtë qëllim².

Në zbatim të ligjit nr. 33, datë 09.04.2024 “Për dhënie Amnistie”, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë kishin përfituar 22 burgosur, duke ulur numrin e të burgosurve në mënyrë të konsiderueshme, por përsëri numri i akomodimit në IEVP, mbetet i lartë duke mos ju përgjigjur standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në këtë institucion.

Institucioni i Avokatit të Popullit e konsideron si një problematikë të qënësishme, duke pasur parasysh kapacitetet e lejuara për akomodimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve në këtë institucion.

Fenomeni i mbipopullimit është evident edhe në 3 muajt e parë të vitit 2024, sipas grafikut të evidentuar sa më lart. Në vlerësimin tonë, nisur nga fakti se IEVP Vlorë është institucion me 3 sektorë paraburgimi dhe 1 sektor burgimi, situata e mbipopullimit veç mungesës së kapaciteteve akomoduese është në varësi edhe të dinamikës së vendimeve që marrin Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ndaj, në kushte të tilla është tepër e domosdoshme që DPB e cila bën planifikimin e kapaciteteve akomoduese për çdo IEVP, të kërkojë edhe shpërndarjen e të paraburgosurve në IEVP-të e tjera më të afërta me Prokuroritë dhe Gjykatat e e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, pasi të burgosurit që jetojnë në ambientet e këtij institucioni janë në kushte trajtimi jo dinjitoz.

² Vendimi nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, në nenin 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

Theksojmë se Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT), gjatë vizitës së tij në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018, ka rekomanduar për I EVP-të, se: *“Edhe pse numri i përgjithshëm i të burgosurve është ulur krahasuar me vizitat e mëparshme, autoritetet shqiptare duhet të mbajnë në konsideratë mangësinë e përmbushjes së standardit minimal prej 4 m² të hapësirës për person, kur në to sistemohen më shumë persona (në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit që mund të ndodhet brenda dhomës)”*³.

Ky shqetësim është adresuar edhe në rekomandimet tona të mëparshme, bazuar edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, standard i cili duhet të respektohet plotësisht në praktikë.

Godinat në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit, garantonin sigurinë dhe kushtet e qëndrimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, për kryerjen e veprimeve sipas orarit ditor, si dhe ofronin mundësi për të përballuar dinamikën e hyrjeve të reja dhe transferimit të të paraburgosurve në I EVP-të e tjera, situatë kjo që ndryshonte çdo ditë në varësi të vendimeve të gjykatave.

Organika e miratuar për I EVP Vlorë përbëhej nga 145 punonjës, nga të cilët 34 ishin punonjës civil dhe 111 punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë së institucionit. Aktualisht, organika e I EVP Vlorë, përbëhej nga sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve, sektori ligjor, sektori financiar, sektori i logjistikës, sektori shëndetësor dhe sektori i policisë. Në tërësi organika ishte e plotësuar, por kishte mungesa në 10 (dhjetë) ndihmës inspektorë të nivelit bazë të sektorit policor, si dhe në sektorin shëndetësor me 1 (një) mjek të përgjithshëm me kohë të pjesshme dhe 1 (një) stomatolog me kohë të pjesshme.

Gjithashtu, drejtuesi i institucionit na informoi se për persona të shëndetit mendor në I EVP Vlorë ofrohet mjeku psikiatër në bashkëpunim me Institucionin e Ekzekutimit të Vendime Penale Fier, për vlerësimin e përmirësimin e shërbimit të shëndetit mendor dhe për të garantuar ruajtjen e shëndetit të këtyre personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Nisur nga informacioni i stafit të institucionit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm⁴ rezultoi se:

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për vlerësimin dhe përmirësimin e shërbimit të shëndetit mendor në sistemin penitenciar.
2. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për shtimin e palestrës me materiale, si gira, shtanga sipas peshës dhe vegla të tjera që ndihmojnë të paraburgosurit të kalojnë kohë shlodhëse në këtë drejtim.
3. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve social-kulturore e sportive me pjesëmarrjen e të dënuarve, që shërbejnë për rehabilitimin dhe ri-integrimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve.

³ Shih: <https://rm.coe.int/168097986b> “Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2019) fq. 32.

⁴ Rekomandimi i dërguar me shkresën nr. K4/I14-2 prot., datë 08.06.2023.

Ndërkohë, një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar⁵. Më konkretisht:

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për hidroizolimimin e tarracës të godinës së banimit, për eliminimin e lagështirës në dhomat e të paraburgosurve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve.
2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për kryerjen e investimeve në ambientet e banimit të të paraburgosurve, me qëllim eliminimin e lagështirës.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për garantimin e akomodimit të të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6 m² dhe 4m² për person.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin në godinën e të paraburgosurve të sistemit qendror për ngrohje/ftohjen e ambienteve të brendshme të institucionit, si dhe garantimin në çdo kohë të furnizimit me ujë të ngrohtë për mbajtjen e higjienës personale të të paraburgosurve dhe të ambienteve të përbashkëta, në përshtatje dhe me kushtet klimaterike të zonës.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë në ditë në ambientet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, dhe deri në realizimin e plotë të investimit të rritet numri i orareve të furnizimit me ujë në 10 orë në ditë nga 6 orë që është aktualisht.
6. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për vënien në funksion të të gjitha dusheve, si dhe lysterjen e ambienteve për të qenë sa më të pastra nga ana higjiene-sanitare.
7. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për plotësimin sipas strukturës organike të sektorit shëndetësor me të paktën me 1 mjek të dytë të përgjithshëm part-time dhe 1 stomatolog, me kohë të plotë në institucion, me qëllim garantimin cilësor të shërbimit shëndetësor për të burgosurit pacientë kronikë dhe të burgosurit e tjerë.
8. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për vënien në funksion të ambienteve të pashfrytëzuara, të cilat qëndrojnë të mbyllura në institucion.
9. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për vendosjen e një tende për mbulim në sektorin e ajrimit në IEVP Vlorë.
10. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këtë kategori.
11. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV) në IEVP Vlorë.
12. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.
13. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen me komodina sipas kushteve normale për jetesë në dhomat e observimit, me kushte higjiene-sanitare të pastra dhe dezinfektim të shpeshtë të këtyre ambienteve në IEVP Vlorë.

Është rasti të theksojmë se garantimi i kushteve për trajtimin me dinjitet të të burgosurve, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të tyre, parandalimi i sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtëruar apo degradues, si dhe rekomandimet e CPT-së dhe të Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato ju drejtohen. Për sa më sipër, grupi i inspektimit u informua nga stafi i IEVP Vlorë, se ky institucion i është drejtuar në mënyrë të vazhdueshme Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për mbështetje financiare për përmirësimin e kushteve në këtë institucion.

⁵ Kthim përgjigje shkresës tonë me nr. 659 prot, datë 16.10.2023 nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë.

Trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve

Objekti i vizitës inspektuese të grupit të monitorimit ishte trajtimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve, identifikimi i rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar në aktet normative, apo presionit psikologjik ndaj tyre, si dhe përdorimi efektiv i masave disiplinore në bazë të kushteve dhe kritereve të përcaktuara në aktet ligjore kombëtare dhe aktet ndërkombëtare të fushës.

Nga informacioni që u grumbullua gjatë vizitës inspektuese dhe intervistimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve, grupi monitorues nuk konstatoi raste apo pretendime të të burgosurve, lidhur me keqtrajtim apo tejkallim të forcës fizike nga ana e punonjësve të shërbimit të sigurisë apo stafit të institucionit.

Grupi i inspektimit, një vëmendje të veçantë i kushtoi këqyrjes së procedurave që ndiqen nga stafi i institucionit për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të të burgosurve nga administrata e institucionit, funksionimit të Komisionit të Pritjes në lidhje me trajtimin e të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion, funksionimin e Komisionit për Dhënie e Masave Disiplinore, cilësisë së aktiviteteve që zhvillohen me të burgosurit, ofrimit të shërbimit dhe trajtimit shëndetësor të të burgosurve, cilësisë dhe larmishmërisë së ushqimit, furnizimit të të burgosurve sipas normativave mujore me detergjentë dhe mjete të higjienës personale, etj.

Gjithashtu nga grupi i inspektimit u verifikua plotësimi i kushteve materiale të jetesës për të paraburgosurit dhe të dënuarit në këtë institucion. Inspektimi u përqëndrua kryesisht tek kushtet e banimit, mbipopullimi në dhoma, higjiena personale, kushtet sanitare, veshjet, cilësia e përgatitjes dhe shpërndarjes në kohë të ushqimit, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë.

Theksojmë se, infrastruktura në regjimin e brendshëm të institucionit ishte e plotë dhe funksionale, e cila mundësonte jetesë normale dhe llojshmëri të zhvillimit të aktiviteteve me të burgosurit. Godinat, dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta në regjimin e brendshëm, ishin në gjendje të mirë teknike.

Në godinën e IEVP-së ishte evidente lagështira, më e theksuar në ambientin e tualeteve në këtë institucion. Niveli i lagështirës ishte tej normave të lejuara dhe për pasojë prezenca e saj në këto ambiente, ndikon drejtpërdrejt në jetën dhe shëndetin e të paraburgosurve dhe të të dënuarve, si dhe për vetë punonjësit e policisë së burgut.

Personat e moshës 18-21 vjeç **nuk** ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këta persona, por ata ishin të shpërndarë në dhoma me të burgosurit e tjerë. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta, ishte i pamundur për shkak të mospërshtatjes dhe familjarizimit që ata kishin me të burgosurit e tjerë. Ajrimi dhe veprimtaritë me karakter sportiv dhe edukativ, vijonin të zhvilloheshin me grupe të ndarë sipas grup moshave dhe interesave të të burgosurve.

Nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të burgosurit, rezultoi se kishte disa ankesa që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion. Ato

konsistonin në përkeqësimin e kushteve të jetesës në disa dhoma banimi, për shkak të mbipopullimit të tyre mbi kapacitetin fizik; në prezencën e lagështirës në disa dhoma banimi dhe kryesisht në ambientet e përbashkëta si në tualete dhe dushe; problemet me sistemin elektrik; mungesën e ujit të ngrohtë për larjen e trupit, etj.

Grupi i inspektimit, mori ankesa nga të burgosurit edhe për mosfunksionimin e sistemit të kaldajës (chiller), që shërben për ngrohje/ftohjen e ambienteve në regjimin e brendshëm. Ky shqetësim bëhej serioz gjatë stinës së dimrit kur temperaturat në këtë zonë ishin të ulta deri nën zero. Institucioni për periudhën e dimrit kishte lejuar futjen në regjimin e brendshëm të ngrohseve elektrike, ndërsa në verë të pajisjeve elektrike për ftohje, të cilat veç funksionit të tyre, kishin rritur ngarkesat në rrjetin elektrik dhe dëmtonin sistemin e brendshëm elektrik.

Një problematikë që u evidentua nga intervistat me të burgosurit, kishte të bënte edhe me zvarritjet në zbardhjen e vendimeve nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe ekzekutimin në kohë të tyre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga verifikimi i disa ankesave të të burgosurve, rezultoi se zvarritja e vendimeve shkonte deri në 4 muaj. Ky konstatim ka të bëjë me procedurat gjyqësore dhe të prokurorisë, por edhe institucionet duhet të bashkëpunojnë më shumë dhe të jenë më proaktive me administratat respektive, pasi është e pajustificuar një zvarritje kaq e gjatë e zbardhjes së vendimeve gjyqësore.

Kjo problematikë sjellë për pasojë cënimin e të drejtave të të dënuarve të cilët janë në pritje të zbardhjes së vendimit edhe pse ky vendim është shpallur muaj më parë. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 06.04.2022 “Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, të dënuarve duke qëndruar ende me statusin e të paraburgosurit në IEVP ju kufizohen të drejta të parashikuara në këtë rregullore, konkretisht të parashikuara në nenet 65, 66,70, 79, 101 etj.

Ankesa u paraqitën dhe për mungesën e larmisë së ushqimit, e cila sipas pretendimeve të tyre, ishte e njëjtë për çdo stinë. Nga inspektimi i ambientit të kuzhinës, u konstatua se menuja javore ishte e afishuar dhe e miratuar nga komisioni i institucionit, por ajo ishte e njëjtë dhe e pandryshueshme çdo ditë të javës. Cilësia e gatimit të ushqimit ishte e mirë, por në dhomat e banimit, grupi i inspektimit gjeti pajisje për gatimin e ushqimit dhe të burgosur që gatuanin nga ushqimet e dërguara nga familjarët e tyre.

Në IEVP Vlorë ishin të punësuar 14 të burgosur, siç ishte përcaktuar në strukturën organike, në pozicione pune si sanitar, nd/kuzhinier, mirëmbajtjes, lavanderi, berber etj. Institucioni kishte lidhur kontratat e punës me të punësuarit dhe pagesat kryeshin çdo muaj, duke i derdhur në numrat e llogarive të të punësuarve në bankat e nivelit të dytë. Në çdo rast, IEVP Vlorë garanton se fondi i pagave për 14 të punësuarit e miratuar nga DPB-ja është në buxhetin e institucionit, dhe është efektiv pasi të hapen numrat e llogarisë në bankë nga çdo i punësuar.

Masat mbrojtëse

Në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe stafin e institucionit u kërkua informacion për sistemin e kërkesë/ankesave, ku rezultoi se ai zbatohet sipas Urdhrit të Drejtorit të

Përgjithshëm të Burgjeve⁶. Në urdhër, përcaktohen personat përgjegjës të autorizuar të cilët në mënyrë periodike marrin kërkesë/ankesat e të burgosurve, kryejnë regjistrimin në regjistrin përkatës dhe protokollimin e tyre, si dhe janë përgjegjës për trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar nga titullari i institucionit⁷. Regjistri i kërkesë/ankesave ruhet dhe administrohet nga sekretaria e institucionit.

Të burgosurit, pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese ia dorëzonin më pas punonjësit të edukimit, sipas sektorëve që mbulonin. Më tej, punonjësi i edukimit, kërkesë/ankesat e të burgosurve brenda ditës i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili nëpërmjet sektorëve përgjegjës, kthente përgjigje në kohë sa më të shpejtë.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, për vitin 2024 ankesat/kërkesat e të burgosurve kishin për objekt kryerjen e vizitave mjekësore te mjeku i institucioni apo për vizitë pranë mjekut specialist në Spitalin Rajonal Vlorë, biseda në “Skype” me familjen, blerje të pajisjeve si TV dhe pajisje elektrike për ngrohje, pajisjen me kopje të vendimit të gjykatave, konsulenca juridike, etj. Sipas verifikimit në regjistër të gjitha kërkesat ishin zgjidhur brenda afatit ligjor, ndaj dhe grupit të inspektimit nuk ju paraqitën ankesa për stafin e institucionit në lidhje me procedurat që ndiqen për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të tyre, por ata ngritën si pretendim mungesën e kontaktit me juristin e institucionit, për dhënien e asistencës ligjore në lidhje me çështje që shqetësojnë ata.

Gjatë inspektimit, u verifikuan gjithashtu procedurat e ndjekura për hyrjet e reja të të burgosurve në institucion, intervistimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve, evidentimi i gjendjes shëndetësore dhe psiko-sociale të tyre, si dhe mënyra e plotësimit të regjistrit dhe dosjeve personale të të burgosurve. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni u konstatua se, procedura e pranimit të të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion zbatohet në mënyrë korrekte nga Komisioni i Pritjes, praktikë kjo e cila ishte e evidentuar në libër dhe në regjistrin përkatës. Më tej, dokumentacioni protokollohej në sekretarinë e institucionit.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Ato monitoronin ambientet në regjimin e brendshëm, si dhe mjediset e jashtme të institucionit përgjatë 24 orëve. Të dhënat nga regjistrimet e kamerave ruhen në server për një periudhë 30 ditore.

Theksojmë se mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të IEVP-së Vlorë, përveç mjediseve ku çënohet privatësia, është vlerësuar nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, si një masë mbrojtëse ndaj personave të privuar nga liria.

Komunikimet me telefon me familjet e tyre, të burgosurit i zhvillonin normalisht në telefonat me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjendje pune dhe të burgosurit kryenin 8 telefonata në muaj me familjarët dhe të afërmit e tyre.

Grupi i inspektimit konstaton se në IEVP Vlorë nuk ishin afishuar posterat me të drejtat e të burgosurve, nëpër sektorët e regjimit të brendshëm të këtij institucioni për të qenë të aksesueshëm për të burgosurit dhe për t'u njohur sa më mirë me të drejtat e tyre.

⁶Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

⁷Neni 58 i ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Grupi i inspektimit, verifikoi komunikimin me telefon me Institucionin e Avokatit të Popullit, në numrat e kontaktit që ishin të afishuar në hollin e secilit sektor. Nga verifikimi rezultoi se, të burgosurit mund të komunikojnë në çdo kohë dhe pa pagesë, sikurse parashikohet në ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Vizitat e të burgosurve me familjarët e tyre kryheshin rregullisht 4 herë në muaj, nga të cilat 3 takime fizike dhe 1 takim online⁸. Institucioni ka ambiente për takime fizike me familjarët. Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët në IEVP Vlorë, kishte 1 post për takime online, 4 poste për takime fizike me familjarët e të paraburgosurve dhe të dënuarve, 1 dhomë prindërimi në distancë dhe 1 dhomë për takime speciale me familjarët. Këto mjedise ishin të kompletuara me stola për qëndrimin ulur të personave dhe ndahen në mes nga një xham i trashë, i cili nuk i lejon të takohen fizikisht. Ambienti i takimeve online, ishte i pajisur me një kompjuter për komunikimin me “Skype”.

Procedurat e takimit të të burgosurve me familjarët zhvilloheshin çdo ditë sipas listës së miratuar nga drejtori i IEVP-së. Nga intervistat, të burgosurit nuk paraqitën ankesa në lidhje me procedurat për takimin dhe komunikimin me telefon me familjarët e tyre.

Dhoma e prindërimit në distancë, ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ku të burgosurit mund të takonin fizikisht fëmijët e tyre. Gjatë takimeve me fëmijët dhe familjarët në këto dhomë, respektoheshin masat e sigurisë, por dhe privatësia e takimit.

Kushtet materiale

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë është një institucion i ri, ndërtuar në vitin 2008, me infrastrukturë të plotë e funksionale në regjimin e jashtëm dhe të brendshëm të tij, sipas të gjitha standardeve të përcaktuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Kushtet materiale të institucionit në funksion të të paraburgosurve dhe të dënuarve, ishin të plotësuara dhe garantonin standarde përgjithësisht të pranueshme për jetesë normale dhe zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor, edukativ dhe sportiv, për rehabilitimin e kësaj kategorie, me përjashtim të disa çështjeve të trajtuara më lart për sistemin ngrohje/ftohje, lagështirën etj.

Ambientet në çdo sektor në regjimin e brendshëm, ishin sipas standardeve përsa i përket llojshmërisë së aktiviteteve ditore, si klasa edukimi dhe këshillimi psiko-social, dhoma për takimet me familjarët, dhoma e prindërimit në distancë, klasa ku zhvillohet mësimi dhe zhvillimi i kurseve profesionale, si dhe ambiente kulturi të ndara më vete për besimtarët mysliman dhe katolik. Veç këtyre ambienteve, grupi i inspektimit konstatoi dhe disa ambiente (dhoma) të tjera, të cilat ishin të mbyllura dhe pa funksione. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, ato ambiente janë të ndërtuara që nga zbatimi i projektit, por nuk përdoren pasi nëse ato vihen në funksion, kërkojnë staf mbështetës dhe staf sigurie shtesë nga struktura organike e miratuar.

⁸ Neni 70 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM-në nr.209, datë 06.04.2022 parashikon se: “Të burgosurit kanë të drejtën e zhvillimit të vizitës të paktën 4 (katër) herë në muaj me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, me një kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë. Të burgosurit kanë të drejtë të zëvendësojnë 1 (një) vizitë fizike me atë online”.

Gjendja e godinave, ambientet e ajrimit, ambientet e përbashkëta dhe parametrat teknik të ndërtimit të dhomave të banimit, ishin në gjendje të mirë dhe plotësonin kërkesat e të burgosurve. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, përbëhej nga dy godina, A dhe D, secila nga tre kate, me 43 dhoma në total. Nisur nga infrastruktura e brendshme, në katin e parë ndodhen ambientet e përbashkëta për takime me familjarët, kuzhina, lavanderia, dhe dushet e përbashkëta për të burgosurit. Ndërsa, në katin e dytë ndodheshin salla e TV, palestra, biblioteka, ambientet e kultit fetar, klasat e kurseve profesionale, etj.

Sikurse e theksuam edhe më lart, një problem tjetër i evidentuar nga grupi i inspektimit ishte mbipopullimi në dhomat e banimit, pasi në dhoma u gjetën të akomoduar 2, 3, 4 dhe 6 persona, si dhe tejkalimi i normës prej 4 m² hapësirë jetike për person, e cila konsiderohet shkelje e standardit të sipërfaqes së banimit që duhet të disponojë një person i burgosur⁹. Shkelja e këtij standardi është evidentuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitave monitoruese në Shqipëri, i cili në përfundim të vizitës i ka rekomanduar autoriteteve shqiptare se: *“Të dënuarit/ paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo më pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi”*.

Në vijim të këtij rekomandimi, edhe në ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” përcaktohet shprehimisht se: *“Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”*.¹⁰

Dhomat e banimit ishin të kompletuara me materiale për fjetje si dyshekë, batanije, jastëk dhe çarçafë, të cilat ishin në gjendje të mirë përdorimi. Dritaret mundësonin ndriçim natyral të bollshëm. Ambientet në regjimin e brendshëm kishin energji elektrike të pandërprerë për ndriçim dhe nevoja të përditshmërisë, që furnizohej nga rrjeti elektrik, por kishte dhe burim energjie rezervë me gjenerator, për furnizimin me energji elektrike në rast ndërprerjeje.

Kushtet e dhomave, sipërfaqet dhe hapësirat ishin të përshtatura duke mos respektuar hapësirën jetike për person. Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete brenda, me kushte të mira higjieno-sanitare. Dhomat **nuk** ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe ruajtjen e ushqimit të të burgosurve, por sikurse rezultoi në shumicën e rasteve këto orendi e pajisje ishin siguruar nga familjarët e tyre, për mbajtjen e ushqimit në kushte normale dhe të përshtatshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit u evidentua se, të paraburgosurit dhe të dënuarit ishin furnizuar me detergjentë, kova, fshesa dhe letra higjienike, sipas normativa mujore nga sektori i logjistikës. Ndërkohë, ata pretendonin se këto normativa janë të pamjaftueshme

⁹ Neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe neni 30 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

¹⁰ Neni 33, pika 4 e ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

dhe nuk plotësojnë nevojat e të burgosurve për mbajtjen e higjienës personale, për larjen e rrobave dhe mbajtjen pastër të ambientit të dhomave dhe atyre të përbashkëta. Në këto kushte, të burgosurit detyrohen të sigurojnë detergjentë shtesë nga familjarët, duke rritur koston ekonomike të familjeve të tyre.

Ambienti i dusheve ishte i përbashkët dhe ndodhej në katin e parë të institucionit. Ky ambient kishte nevojë për lyerje dhe për për t'u mbajtur pastër nga ana higjiëno-sanitare. Duset nuk ishin funksionale, pasi atyre u mungonin kokat e dusheve dhe për pasojë të burgosurit laheshin në dhomat e tyre. Për këtë problematikë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur se institucioni duhet të parashikojë fonde për mirëmbajtjen e vazhdueshme të këtyre ambienteve.

Një nga shqetësimet e ngritura në intervistat me të paraburgosurit dhe të dënuarit ishte mungesa e një ambienti më vete për tharjen e rrobave, pasi në mungesë të një ambienti më vete, tharja e rrobave kryhej brenda dhomave të banimit, duke përdorur mjete të tilla si kordona apo litarë për varjen dhe tharjen e tyre. Mbajtja e kordoneve apo litarëve në dhomat e banimit përbën rrezik për jetën, kryesisht të atyre personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, por dhe për sigurinë e të burgosurve të tjerë.

Gjithashtu, institucioni kishte ambiente ajrimi, konkretisht, ku godina A ka 3 bokse ajrimi dhe godina D, ka 2 bokse ajrimi, si dhe një fushë sporti për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive të programuara, por bokset e ajrimit ishin të pambuluara në rastet e kryerjes së ajrimit në mot me shi.

Furnizimi me ujë i ambienteve të institucionit kryhet nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Vlorë. Furnizimi me ujë i ambienteve në regjimin e brendshëm kryhej sipas një grafiku 3 herë në ditë nga 2 orë. Mungesa e ujit të rrjedhshëm dhe cilësia e ujit, ishte një ankesë e ngritur nga të burgosurit, pasi koha ishte e pamjaftueshme për mbajtjen e higjienës personale dhe njëkohësisht për mbajtjen e pastërtisë së ambienteve të banimit. Ata deklarorin se, uji nuk është i cilësisë së mirë dhe nuk mund të përdoret për tu pirë dhe as për gatim. Uji i pijshëm blihej nga të burgosurit nëpërmjet "Marketit online", duke rritur kostot e buxheteve të familjeve të tyre. Ndërkohë, furnizimi me ujë të pijshëm i të burgosurve është një e drejtë që duhet të sigurohet nga institucioni¹¹. Të burgosurit kërkonin të kishin ujë pa ndërprerje, sidomos tani që po afron stina e verës, pasi koha e furnizimit me ujë ishte e pamjaftueshme për larjen e trupit dhe pastërtinë e ambienteve të banimit.

Grupi monitorues inspektoi situatën e trajtimit, kushteve materiale dhe higjienike të të burgosurve në ambientet e observim/veçimit. Ky ambient përbëhej nga 2 dhoma observimi dhe 2 dhoma veçimi. Në ditën e inspektimit, ambienti i observimit ishte pajisur me një krevat, dyshek, batanije, si dhe çarçafë. Gjithashtu, kishte 1 person në dhomat observim/veçimit. Ambienti nuk ishte i pastër nga ana higjiëno-sanitare dhe kishte nevojë për lyerje. Problematikë në këto ambiente ishte gjithashtu dhe mungesa e dushit për larjen e trupit të personave, pasi në mungesë të tij, larja e trupit duhet të bëhej në ambientet e dusheve të përbashkëta sipas sektorëve.

¹¹ Neni 27 i ligjit nr. 81/2020 parashikon se: "Të paraburgosurve dhe të dënuarve duhet t'u sigurohet në vazhdimësi ujë i pijshëm".

Ushqimi për të paraburgosurit dhe të dënuarit gatuhet në kuzhinën e institucionit, e cila ishte me hapësirë e sipërfaqe të madhe, si dhe me ambiente më vete për gatimin e ushqimit dhe për ruajtjen e tij. Kuzhina ishte e kompletuar me pajisje frigoriferike për secilin produkt ushqimor më vete, me pajisje kuzhine alternative (elektrike dhe gaz) për gatimin e vakteve ushqimore, me vaska me kapak dhe enë kuzhine të nikeluara e të pastra, si dhe me karroca për shpërndarjen e ushqimit, sipas sektorëve të të paraburgosurve. Në godinat e banimit janë të instaluar ashensorët, por u konstatua se ashensorët nuk ishin në gjendje pune. Institucioni i kishte adresuar me shkresë DPB-së, kërkesën për riparimin e ashensorëve ose planifikimin në buxhetin e I EVP Vlorë të fondeve për mirëmbajtjen dhe vënien në funksionim të tyre në të dy godinat e banimit.

Në kuzhinë ndodhet e afishuar kuota ditore, menuja, si dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës, ndërsa gatimi i ushqimit kryhet sipas kategorive të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Burgjeve më vete për të burgosurit, për të punësuarit, si dhe për të sëmurët diabetik.

Personeli i kuzhinës përbëhet nga 4 kuzhinierë sipas strukturës organike dhe 6 ndihmës kuzhinierë, të punësuar nga radhët e të burgosurve. Në intervistat me të burgosurit, nuk u paraqitën ankesa lidhur me cilësinë dhe shpërndarjen e ushqimit por ata ngritën shqetësim për larminë e ushqimit.

Regjimi dhe aktivitetet

Regjimi dhe aktiviteti i të paraburgosurve ishte i përcaktuar në orarin e veprimeve ditore të miratuar nga titullari i këtij institucioni. Orari i veprimtarive ishte miratuar nga drejtori i institucionit dhe unifikuar për të gjithë sektorët, pavarësisht sigurisë së të paraburgosurve dhe aktiviteve që zhvilloheshin sipas grupmoshave dhe kategorive, më vete për ata.

Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta nga të cilat mund të përfitonin të paraburgosurit dhe të dënuarit, të cilat ishin kryesisht, lojërat e tavolinës siç janë lojërat me letra, domino, aktivitetet fetare, kalçeto, trajtimi periodik i temave sociale nga specialistët e edukimit në sektorin përkatës, etj. Temat sociale janë realizuar në klasat e këshillimit, duke krijuar fokus grupe me kategori të ndryshme me të burgosurit, për të ardhur në ndihmë rehabilitimit sa më shpejt në kushtet e privimit nga liria. Në ambientet e regjimit të brendshëm nga sektori i edukimit realizohet plani ditor i aktiviteve ku realizohen aktivitete sportive, si futbollin në kalçeto dhe palestra. Në këtë institucion ishin dy palestra, ku të burgosurit bënin aktivitete fizik sipas planit të aktiviteve ditore të miratuar nga institucioni. Të burgosurit nuk ngritën pretendime në lidhje me këto aktivitete fizike të bëra nga ana e tyre.

Nga ana dokumentare, sektori i çështjeve shoqërore kishte të hartuar programe mujore pune, programe për trajtimet individuale psiko-sociale, si dhe plane mujore të aktiviteve. Në rastin e festave kombëtare dhe festave fetare, në bashkëpunim me sektorin e policisë, ishin organizuar aktivitete të veçanta. Për secilin të burgosur ishin të plotësuar dosjet psiko-sociale.

Nga verifikimi i dokumentacionit, sektori i çështjeve shoqërore kishte të miratuara planet për zhvillimin e aktiviteve sportive me të burgosurit, si dhe programet individuale të këshillimit të ndarë më vete për moshat 18-21 vjeç dhe për grup moshat e tjera.

Gjithashtu, në I EVP Vlorë ka filluar zhvillimi i procesit arsimor, ku pjesë e këtij procesi janë të burgosurit të cilët nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar. Procesi arsimor në kushtet e kufizimit të jetës së lirë realizohet nga 3 (tre) mësuese, të cilat përkatësisht japin lëndët shkencore, shoqërore dhe ciklin e ulët. Aktualisht ishin 8 të burgosur që frekuentonin arsimin e detyruar 9 vjeçar në kushtet e privimit nga liria. Po ashtu kishte filluar dhe procesi i arsimit të mesëm të përgjithshëm në I EVP Vlorë sipas akteve që normojnë sistemin arsimor parauniversitar. Aktualisht ishin 10 të burgosur që u ishte krijuar mundësia për arsimim të mesëm në këtë institucion.

Në I EVP Vlorë, në mënyrë të vazhdueshme janë zhvilluar kurset profesionale për elektrikist dhe saldator, për gjuhën angleze, si dhe punë artizanale. Në këto kurse marrin pjesë të burgosur, të cilët i frekuentojnë rregullisht dhe në përfundim të kursit pajisen me certifikatë pjesëmarrjeje. Aktualisht këto kurse zhvillohen çdo ditë sipas programit të përcaktuar dhe kishte 9 të burgosur për secilin kurs.

Është për t'u theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është ri-integrimi në shoqëri i personave, në momentin që do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se: *“Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹².

Mekanizmi Kombëtar thekson nevojën e vazhdueshme të ndërthurjes së aktiviteteve kulturore-sportive dhe edukative me të burgosurit sipas grup moshave dhe kategorive, si dhe hartimin e programeve për këshillimin dhe trajtimin individual të këtyre personave, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet tek këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive me botën jashtë, gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit.

Biblioteka e institucionit ishte funksionale dhe ishte furnizuar me libra të rinj. Në bibliotekë ishte i punësuar një i paraburgosur, i cili e mirëmbante atë dhe plotësonte kartelat për çdo të dënuar që kishte interes për leximin e librave.

Ajrimi i të dënuarve realizohej sipas orarit ditor, por në mënyrën që janë të organizuara godinat në regjimin e brendshëm të institucionit, të dënuarit qëndronin në ajrim edhe jashtë këtij orari. Në regjimin e brendshëm ndodheshin 5 ambiente ajrimi (çdo sektor më vete) dhe një fushë futbollit, ku lejoheshin të zhvilloheshin aktivitete sportive me grupe.

Mungesa e Rregullores së Brendshme të I EVP Vlorë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, mund të sjellë pengesë në kryerjen e detyrave të menaxhimit të sigurt dhe njerëzor të të burgosurve dhe ofrimit të mundësisë së rehabilitimit dhe ri-integrimit të tyre. Nga drejtuesit e institucionit u informuam se i është dërguar për miratim Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Rregullorja e Brendshme e institucionit në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, por ende nuk është miratuar nga ky institucion.

Shërbimi shëndetësor

¹²Rregullorja e Evropiane e Burgjeve, Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Shërbimi shëndetësor për të burgosurit në këtë institucion, ofrohej sipas standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe ato ndërkombëtare, pasi të burgosurit gëzojnë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në dispozicion edhe të komunitetit.

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës inspektuese në I EVP Vlorë, i kushtoi një rëndësi të veçantë funksionimit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor të të burgosurve, për garantimin dhe ruajtjen e shëndetit të këtyre personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Struktura organike e personelit shëndetësor të institucionit, përbëhej nga 8 punonjës, nga të cilët 1 (një) mjek i përgjithshëm me kohë të pjesshme, 1 (një) stomatolog, me kohë të pjesshme, 1 (një) farmacist dhe 5 (pesë) infermierë. Mjeku i përgjithshëm dhe stomatolog ishin të punësuar me kohë të pjesshme 4 orë në ditë sipas kontratës të punës, por paraqiteshin menjëherë në çdo kohë në institucion në rastet e urgjencës apo në rastet e kërkesave dhe nevojave që mund kishin të burgosurit e institucionit.

Vizitat mjekësore nga mjeku i institucionit, kryheshin sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, me kërkesë të të burgosurve dhe miratim të drejtorit të institucionit. Koha në dispozicion për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku, ishte në varësi të numrit të kërkesave dhe diagnozës që paraqisnin të burgosurit. Vizitat mjekësore pranë mjekëve specialist në Spitalin Rajonal të Vlorës, me rekomandimin e mjekut të institucionit, kryheshin në varësi të masave së sigurisë për lëvizjen e të sëmurëve nga I EVP Vlorë për në spital, mundësisht menjëherë për rastet urgjente, ndërsa për të sëmurët kronikë koha e pritjes shkonte deri në 10 ditë. Nga intervistat me të burgosurit, nuk u paraqitën ankesa në lidhje me vonesa në kryerjen e vizitave mjekësore në Spitalin Rajonal të Vlorës apo në Spitalin e Burgjeve në Tiranë.

Në I EVP Vlorë kishte 30 persona të sëmurë kronik, 13 persona të sëmurë të shëndetit mendor, 1 person epileptik, si dhe 1 burgosur si përdorues lëndësh narkotike (që marrin trajtim me metadon), të cilët trajtoheshin me medikamente, ushqim dhe vizita mjekësore sipas rekomandimeve të mjekëve specialist.

Shërbimi shëndetësor ndodhej në katin e dytë të godinës në regjimin e brendshëm, në një ambient të veçantë ku ndodhej dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia, si dhe dhoma për konsultat ditore dhe rastet e urgjencës.

Dhomat e vizitave ishin të plotësuara me krevat dhe shtroje, në kushte të mira higjieno-sanitare. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri dhe funksiononte rregullisht për ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

Dhoma shtrimi ishin 5 (pesë), ku 3 (tre) dhoma ishin të pajisura me 1 (një) shtrat, dhe 2 (dy) dhoma të tjera me 2 (dy) shtretër. Dhomat spitalore ishin të pajisura me dyshekë, çarçafë, por mungonin pajisjet e domosdoshme për të përmbushur nevojat kryesore të jetesës, si tavolina, stola, komodina. Gjithashtu, për larjen e trupit kishte ambiente të posaçme në fund të korridorit, 2 dushe me ujë të ngrohtë, si dhe 2 tualete të përbashkëta, të cilat ishin funksionale për këtë qëllim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut, u konstatua se, nga ana e tij ishin siguruar konsultime të vazhdueshme me të burgosurit. Sa i përket regjistrave, dhe konkretisht ai i vizitave mjekësore, mjekimeve, konsultave të

specializuara në Spitalin Rajonal të Vlorës, i të sëmurëve mendorë dhe i abuzuesve me substanca narkotike/alkoolit, i personave që refuzojnë terapinë, si dhe regjistri i informacionit 24 orësh të infermierëve, u gjetën të gjithë të sekretuar dhe të mbajtur në rregull. Kartelat mjekësore ishin të mbajtura në mënyrë të saktë dhe të mbyllura në dollap me çelës.

Ndërkohë, konstatoam se nga ana e stafit mjekësor kishte një libër për regjistrimin e rasteve të veçanta dhe të dhunës, ku nga këqyrja e këtij libri rezultoi nuk kishte raste të evidentuara dhe të shënuara. Farmacia e institucionit ishte e furnizuar me medikamente nga DPB-ja. Për të sëmurët kronik, farmacia furnizohej rregullisht me ilaçe sipas skemës trepalëshe mes institucionit, depos farmaceutike dhe Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (DRFSKDSH). Ndërsa për të sëmurët akut, ilaçet siguroheshin nga vetë institucioni, përmes blerjeve të drejtëpërdrejta me fondet e destinuara në buxhetin e institucionit. Grupi i inspektimit nuk mori ankesa nga të paraburgosurit për mungesa në medikamente.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Vlorë, nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë, në një kohë që për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon.

Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin mendor”, ku thuhet se: *“Ekipet multidisiplinare” janë ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave, si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi apo specialistë të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor*¹³. Në këtë kuadër Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të marrë masa specifike për të përmirësuar sa më parë shërbimin e shëndetit mendor për të paraburgosurit.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë për çdo person të sëmurë të shëndetit mendor në këtë institucion në bashkëpunim me Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier, ofron ndihmën mjekësore nga mjeku psikiatër i këtij institucioni, sipas kërkesave apo ankesave të të burgosurve për vlerësimin e përmirësimin e shërbimit të shëndetit mendor dhe për të garantuar ruajtjen e shëndetit të këtyre personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson kushtet infrastrukturore të krijuara për ofrimin e shërbimit shëndetësor të të burgosurve, por thekson se, plotësimi i sektorit shëndetësor me mjek me kohë të plotë do të jetë akoma me eficient për t’iu përgjigjur në kohë kërkesave dhe nevoja të të sëmurëve në këtë institucion, dhe në vlerësimin e MKPT-së, kufizon të drejtën themelore të të burgosurve për të marrë shërbim shëndetësor në kohë sa më të shpejtë, si dhe shërbim shëndetësor cilësor pranë spitaleve apo klinikave mjekësore, që ndodhen në qytetin e Vlorës, si dhe ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për këtë arsye duhen marrë masa të menjëhershme

¹³Pika 4 të nenit 3, të Ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”

për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Avokati i Popullit sjell në vëmendjen tuaj qëndrimet e KPT-së (CPT-së), ku rekomandon se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se, “Shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”, si dhe Rregulloren Evropiane të Burgjeve ku përcaktohet se: “Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”¹⁴.*

Gjithashtu, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve në Vlorë, nuk ishte pajisur me ambulancë si pjesë e domosdoshme për shërbimin cilësor shëndetësor në kohë të shpejtë për të paraburgosurit në këtë IEVP.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ku parashikohet midis të tjerash se: “2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, Mekanizmi Kombëtar ushtron këto kompetenca:*

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”.

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për hidroizolim të tarracës të godinës së banimit, për eliminimin e lagështirës në dhomat e të burgosurve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për kryerjen e investimeve në ambientet e banimit të të burgosurve, me qëllim eliminimin e lagështirës.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për garantimin e akomodimit të të burgosurve në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6 m² dhe 4m² për person.
4. Marrjen e masave, për instalimin në godinën e të burgosurve të sistemit qendror për ngrohje/ftohjen e ambienteve të brendshme të institucionit, si dhe garantimin në çdo

¹⁴ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

kohë të furnizimit me ujë të ngrohtë për mbajtjen e higjienës personale të të burgosurve dhe të ambienteve të përbashkëta, në përshtatje dhe me kushtet klimaterike të zonës.

5. Marrjen e masave të nevojshme nga I EVP dhe UK Vlorë, që të sigurohet furnizimi me ujë të pandërprerë ose zgjatje e orarit të furnizimit me ujë të institucionit, për ruajtjen e higjienës personale dhe të ambienteve ku të burgosurit zhvillojnë aktivitetin e tyre.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për vënien në funksion të të gjitha dusheve, si dhe lryjen e ambienteve për të qenë sa më të pastra nga ana higjieno-sanitare.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin sipas strukturës organike të sektorit shëndetësor me të paktën me 1 mjek të dytë të përgjithshëm part-time dhe 1 stomatolog, me kohë të plotë në institucion, me qëllim garantimin cilësor të shërbimit shëndetësor për të burgosurit pacientë kronik dhe të burgosurit e tjerë.
8. Marrjen e masave të nevojshme, për vënien në funksion të ambienteve të pashfrytëzuara, të cilat qëndrojnë të mbyllura në institucion.
9. Marrjen e masave të nevojshme, për vendosjen e një tende për mbulim në sektorin e ajrimit në I EVP Vlorë.
10. Marrjen e masave të menjëhershme, për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualët e sigurisë për këtë kategori.
11. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV) në I EVP Vlorë.
12. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.
13. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen me komoda sipas kushteve normale për jetesë në dhomat e observimit dhe veçimit me kushte higjieno-sanitare të pastra dhe dezinfektim të shpeshtë të këtyre ambienteve në I EVP Vlorë.
14. Marrjen e masave të menjëhershme nga sektori i sigurisë të institucionit, për heqjen e litarëve në dhomat e banimit që përdoren nga të paraburgosurit për tharjen e rrobave, si element që cënon sigurinë, por edhe si mjet që mund të përdoret për dëmtimin e jetës, kryesisht nga persona që kanë probleme me shëndetin mendor.
15. Marrjen e masave të menjëhershme, për ndryshimin e menisë së ushqimit për ta bërë atë sa më të larmishme dhe përshtatjen e vakteve ushqimore, sipas normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore, për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, gjendjes shëndetësore, kushteve klimaterike, besimit fetar dhe nevojave të veçanta të tyre.
16. Marrjen e masave të menjëhershme nga DPB, për miratimin e Rregullores së Brendshme të I EVP-së Vlorë, në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

17. Marrjen e masave të menjëhershme, për afishimin e posterave me të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve, në çdo sektor për të qenë sa më të aksesueshme për to.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

AHMET PRENÇI